

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-030/14

Prishtinë,

16 dhjetor 2015

Në çështjen juridike të:

H.R.

Konik

81000 Podgoricë

Mali i Zi

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Anders Cedhagen, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/207/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA28997), të datës 11 qershor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 16 dhjetor 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Hysni Ramocit kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/207/2013, të datës 11 qershor 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA28997.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/207/2013, i datës 11 qershor 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA28997.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 24 shtator 2007, H.R. (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon vërtetimin e të drejtës së tij pronësore dhe ri-posedimin e shtëpisë, me sipërfaqe prej 701 m², e cila ndodhet në Rrugën “Jovana Đorđevića”, nr. 35 “Kolonija” në Gjakovë, Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar).

Në kërkesën e tij paraqitësi i kërkesës thekson se ai ka humbur posedimin mbi pronën e kërkuar për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur që kishte ndodhur në Kosovë në vitet 1998/1999, ku ai ka përmendur datën 12 qershor 1999 si datën e humbjes.

2. Për të mbështetur kërkesën e tij ai ka dorëzuar dokumentet vijuese në AKP:
 - Kopjen e fletës poseduese nr. 1340, të lëshuar nga Instituti Gjeodezik i Komunës Kadastrale të Gjakovës, Varosh, Komuna e Gjakovës, më 7 maj 2009. Ky dokument tregon se ngastra nr. 11872 (e përbërë nga “një shtëpi, objekt dhe kopsht”) me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.01.69 ha, është e regjistruar në emër të Z.H.R. (sipas të gjitha gjasave babai i paraqitësit të kërkesës) dhe S.H.R. (mbase xhaxhai i paraqitësit të kërkesës), secili me nga ½.

Prona e përmendur në këtë dokument është me sipërfaqe (dhe adresë) tjetër nga prona që është subjekt i lëndës së kërkesës;

- Fletën poseduese nr. 1339, të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Gjakovës më 13 maj 2009. Ky dokument tregon se ngastra nr. 1187/3 (që përbëhet nga “një shtëpi-objekt”) me sipërfaqe prej 54 m², është e regjistruar në emër të S.R. (mbase xhaxhai i paraqitësit të kërkesës). Prona e përmendur në këtë dokument është me sipërfaqe të ndryshme krahasuar me pronën që është subjekt i lëndës së kërkesës;
 - Kopjen e letërnjoftimit elektronik të paraqitësit të kërkesës. nr.003380356, të datës 15 nëntor 2011.
3. Njësia për verifikim e AKP-së në raportet e saj të datës 8 mars 2010 si dhe raporti i konsoliduar i verifikimit i datës 16 mars 2010, kanë vërtetuar për aq sa është relevante, se fleta poseduese e dorëzuar, në arkivin e Departamentit për Kadastër të Gjakovës ishte verifikuar negativisht.

Sipas raportit të njoftimit të AKP-së të datës 22 shtator 2008, njoftimi i kërkesës ishte bërë dhe ishte konstatuar se A.N. e kishte uzurpuar pronën e kërkuar. Raporti i njëjtë i njoftimit thekson se A.N. ishte i pranishëm në pronë (në kohën e njoftimit) dhe se ai nuk kërkonte të drejtën ligjore ndaj pronës së kërkuar. Me 7 qershor 2011, njoftimi mbi pjesëmarrjen është nënshkruar nga A.N.. Ai ka shpjeguar njëjtë sikur edhe në raportin e përmendur më lartë se ai nuk kërkon të drejtë ligjore në pronën e kërkuar

Njoftimi i kërkesës ishte përsëritur më 20 qershor 2011 dhe ishte konstatuar se personi i njëjtë (Asllan Nuka) e kishte uzurpuar pronën e kërkuar.

4. Më 21 qershor 2011, njoftimi i pronës së kërkuar është vërtetuar. Raporti i vërtetimit shkruan se bazuar në Orto photo-n, koordinatat e GPS-it dhe adresën e pronës së kërkuar, njoftimi i pronës së kërkuar është i saktë.
5. Më 11 qershor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e vet KPCC/D/R/207/2013 kishte refuzuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës. Në paragrafin 30 të vendimit grupor, sqarohet se paraqitësi i kërkesës nuk kishte dorëzuar asnjë provë ose

“asnjë provë që do mund të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive, se bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore gëzon ndonjë të drejtë pronësore ndaj pronës së kërkuar dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka siguruar ndonjë provë të tillë ex officio... “.

6. Më 12 nëntor 2013, vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese). Pala ankuese kishte bërë një ankesë në Gjykatën Supreme më 25 nëntor 2013.
7. Pretendimi i vetëm që pala ankuese kishte bërë në ankesën e tij është se vendimi i KKPK-së është i pasaktë. Si vërtetim të pasaktësisë së vendimit të KKPK-së ai kishte prezantuar kontratën e pa-verifikuar të blerjes, të datës 19 shkurt 1989.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria:

8. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50).
9. Gjykata Supreme duhet të përgjigjet në pyetjen nëse pala ankuese e kishte regjistruar të drejtën e tij pronësore mbi pronën e kërkuar.
10. Pala ankuese nuk ka dorëzuar në AKP/KKPK asnjë provë që dëshmon të drejtën e tij të pretenduar pronësore. Në Gjykatën Supreme ai ka prezantuar një kontratë të blerjes të pa-verifikuar, duke theksuar se vendimi i KKPK-së është i pasaktë por duke mos dhënë asnjë arsye tjetër për këtë.

11. Gjykata Supreme konsideron se kontrata e pa-verifikuar e blerjes, si provë e re e prezantuar nga pala ankuese në procedurën ankimore para Gjykatës Supreme, nuk është e pranueshme dhe nuk mund të merret në konsideratë. Kjo për shkak se neni 12 paragrafi 11 i Rregullores së UNMIK-ut 2005/60 thekson se: *“faktet dhe provat materiale të reja të prezantuara nga ndonjëra palë ndaj ankesës nuk duhet të pranohen dhe të merren parasysh nga Gjykata Supreme veç nëse ajo e dëshmon se faktet dhe provat e tilla nuk kanë mundur në mënyrë të arsyeshme të jenë të ditura nga pala në fjalë ...”*. Gjithashtu, Gjykata Supreme vëren se pala ankuese nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me atë se pse ai nuk ka mundur të ketë dijeni për kontratën në fjalë.
12. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar dhe se KKPK ka marrë një vendim të saktë, të drejtë dhe të bazuar në një procedurë të plotë dhe të saktë dhe jo siç pretendohet nga pala ankuese në ankesën e tij.
13. Nga ajo që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-it 2006/50, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Anders Cedhagen, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it